



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS



VENDIM

Nr. 63, datë 30.12.2016

Për

Dhënie ndihme të menjëhershme financiare të familjeve të **Z. Ramiz Arif Gorrila, Z. Zija Shaban Gorrila dhe Znj. Xhevahire Kadri Gorrila**, për dëmtim shtëpie nga zjarri

Bashkisë Vau Dejës i janë paraqitur nga shtetasit **Z. Ramiz Arif Gorrila, Z. Zija Shaban Gorrila dhe Znj. Xhevahire Kadri Gorrila**, kërkesat për mbështetje financiare për të përballuar dëmet e shkaktuara nga dëmtimi i shtëpisë nga rënia e zjarrit **me datë 06.12.2016**.

Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e një grupi pune për vlerësimin në vend të situatës së banesave të këtyre shtetasve.

Shkak i dëmtimit të këtyre shtëpive është diegia nga zjarri, e vlerësuar nga specialistet e M.Z.SH-së (zjarrfikësve).

Shtëpitë e këtyre shtetasve janë **në një kulm** dhe nuk janë të siguruar në ndonjë agjensi sigurimesh, kjo sipas deklarimeve të këtyre shtetasve.

Kryetari i Bashkisë, bazuar në vlerësimin e grupit të ekspertëve, gjykoj dhënie si ndihmë financiare të shumës prej **10 mijë lekë** (të reja) për secilën familje, **Z. Ramiz Arif Gorrila, Z. Zija Shaban Gorrila dhe Znj. Xhevahire Kadri Gorrila**.

Bazueshmëria ligjore e vendimit është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimit Nr.4 datë 30.09.2015 i KM “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015.

Bashkëlidhur Vendimit është praktika e plotë.




Për sa më sipër, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga diegia e banesave të:

Z. Ramiz Arif Gorrila përbëhet nga **3** (tre) persona.

Z. Zija Shaban Gorrila përbëhet nga **3** (tre) persona.

Znj. Xhevahire Kadri Gorrila përbëhet nga **1** (një) person,

nga fshati Rranxa i Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau Dejës, e ndodhur me datë **06.12.2016**, Këshillit të Bashkisë Vau Dejës në mbledhjen e datës 30.12.2016, me shumicë të cilësuar votash:



VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare të familjeve:
Z. Ramiz Arif Gorrila të përbërë nga **3** (tre) persona.
Z. Zija Shaban Gorrila të përbërë nga **3** (tre) persona.
Znj. Xhevahire Kadri Gorrila të përbërë nga **1** (një) person,
në shumën **10 mijë lekë** (të reja për familje) për të përballuar dëmet e shtëpive, të shkaktuara nga rënia e zjarrit.
2. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i cili do të planifikohet në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2016 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Financës.
4. Ky Vendim u shpall me datë 10.01.2017.

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU